



RAPORT

PËR NJË QEVERISJE FUNKSIONALE NË PËRGJIGJE TË SFIDËS COVID 19 NË BASHKËPUNIM ME KOMUNITETET VENDORE

23-29 MARS

SINTEZË E PERIUdhËS 15-23 MARS

Qeverisja Demokratike: Funkzioni vendimarrës nuk është ndërprerë gjatë emergjencës. Këshillat kishin hapësirë veprimi ligjor, aty ku rregulloret e funksionimit të këshillit ishin të miratuara, edhe para shpalljes së Akti Normativ i dt. 15.03.2020. Votimi me mjete elektronike në distancë është zhvilluar gjerësisht. 29 Këshilla kanë marrë vendime në këtë mënyrë që nga data 15 Mars. Kufizimet në përdorimin e teknologjisë dhe procedurat e reja u tejkaluan përmes këshillimit teknik dhe udhëzimeve të ofruara nga BtF.. Në bashki si Gramshi apo Shijaku u vu re dhe ushtrimi i funksionit mbikqyrës (këshilltarët po monitorojnë punën e grupeve të ndihmës në terren).

Bashkëpunimi Kombëtar-Rajonal-Vendor: Bashkitë bashkëpunuan me institucionet qëndrore, në përgjigje të të nevojave të verifikuara në terren. Policia bashkiake dhe stafet bashkiake krijuan grupe, që ndihmuan me zbatimin e rregullave të sigurisë dhe shpërndarjen e pakove për njerëzit në nevojë. Krijimi i grupeve vullnetare ishte i ngadaltë në ditët e para, por u vu re mobilizim në rritje. Grupeve e vullnetarëve asistojnë në këshillim dhe informim, hpërndarje të ushqimeve/ dheilaçeve tek moshat e treta apo PAK. Është mobilizuar dhe **Telefon Jeshil** (Fier, Tiranë, Durrës).

Transparencë dhe Llogaridhënie: Bashkitë kanë vepruar duke përdorur mjete të ndryshme të komunikimit, si facebook për të shpërndarë video këshilluese për sigurinë (distanca sociale, limiti i lëvizjeve, higjiena) ose EHATSAPP për të ftuar vullnetarë në terren. Është bërë afishim i numrave të telefonit të drejtorive/administratorëve, për të adresuar ankesat apo kërkesat.. Raporte të rregullta të publikuara në ëeb (Shkoder ditor) ose postime facebook mbi veprimet në terren dhe ndërgjegjësimin e komuniteti për të respektuar rregullat. Në Berat, edukatroet ofrojnë mësim përmes TV lokal për moshëm para-shkollore.

Përbushje e Funksioneve Vendore: Bashkitë kanë orientuar veprimtarinë e tyre drejt prioriteteve bazë në këtë periudhë. Ku vëmendje e veçantë i është kushtuar ndihmës ekonomike të shtresave në nevojë. Për të realizuar këtë është aplikuar përdorimi i fondeve të emergjencës/fondit rezervë në funksion të programit ku parashikohen aktivitetet në ndihmë të pandemisë. Më shumë fonde janë mobilizuar për kujdesin social; dezinfektimin eerrugëve dhe menaxhimi mbetjeve, mjete mbrojtëse Në ndihmë të bashkive kanë ardhur dhe bizneset lokale, të cilat kanë ofruar ndihma në ushqime ose materiale (Cërrik biznes fason prodhon maska). Dezinfektimi ka parë shtrirje të kësaj veprimtare edhe në zona rurale dhe ambjente të përbashkëta pallatesh (Tiranë) ku administratorët kanë luajtur rol koordinues.

PËR MË SHUMË INFO KOMUNIKO ME KOORDINATORIN RAJONAL:

[Kliko këtu](#)

This project is initiated and funded by the Swiss Agency for Development and Cooperation SDC, and implemented by Helvetas Albania



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



HELVETAS
ALBANIA



BASHKI të FORTA

QEVERISJE DEMOKRATIKE

Problemi	Modalitete e zgjidhjes	Ku ka ndodhur sukseshëm?
<p><u>Vendimmarrja</u> Njohuri të pamjaftueshme të këshilltarëve mbi përdorimin e mjeteve elektronike & pamundësi për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit në kushtet e "distancës sociale"</p>	<ul style="list-style-type: none"> Përdorim i mjeteve elektronike të komunikimit (Skype, e-mail, WhatsApp) dhe asistencë për përdorimin e tyre së bashku bashkiak të asistuar nga "Bashki të Forta" për hapjen e adresave skype dhe trajnuar mbi teknologjinë para fillimit të komunikimit online nëpërmjet skype. Këto këshilla i janë referuar udhëzimit mbi procedurat e mbajtjes së mbledhjeve në kushtet e përdorimit të mjeteve elektronike (ofruar nga BTF). 	<p>Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejes, Puke, Fushë Arrëz, Tiranë, Rogozhinë, Skrapar, Kurbin, Librazhd Lezhe, Vlore, Pogradec, Korca, Kolonje, Devoll, Maliq, Patos, Lushnje, Polican, Cerrik, Kucove, Tepelena, Kelcyra, Vorë, Mat, Klos & Mallakastër , Rokovec Kukës Kurbin Delvinë, Gramsh ,Peqin Berat , Skrapar, Ure Vajgurore, Krujë , Libohova , Gjirokastra (40 total)</p>
<p><u>Mbikqyrja</u> Monitorimi i grupeve të patronazhit në terren mbi shërbimin që ofrohet</p>	<ul style="list-style-type: none"> Këshilli bashkiak ka caktuar këshilltarë që raportojnë në komitetin e emergjencës. Këshilltarët mbikqyrin grupet e patronazhit për pensionistët e vetmuar dhe invalidët. 	<p>Kukës, Shijak, Shkodër, Gramsh, Tropojë Këlcyrë, Libohovë, Patos LushnjeShijak</p>
<p><u>Veprime të tjera</u> Kufizimi i mbledhjeve të këshillit vetëm për aspekte të emergjencës</p>	<ul style="list-style-type: none"> Procedura të njëjta, të lehtësuara, në format elektronike, aplikohen edhe për vendime rutinë si miratimi i rregulloreve dhe planeve të menaxhimit të mbetjeve (mbështetur nga BTF) 	<p>Tirana, Shkodër, Malësi e madhe, Puke, Fushë Arrëz & Delvinë, Patos, Lushnje, Mallakastër, Maliq, Roskovec, Kukës, Tropojë, Delvine, Librazhd, Cerrik, Peqin, Krujë (9 bashki kane aprovuar rregullore keshilli apo plane menaxhimi mbetjesh)</p>
<p>Krijimi i grupeve të vullnetarëve/patronazhit për të asistuar familjet në nevojë</p>	<ul style="list-style-type: none"> Keshilltarët dhurojnë ndihma dhe ushqime për familjet në nevojë. Këshilltarë të përfshirë në grupet e patronazhit si vullnetarë. 	<p>Kukës, Berat Lezhë, Gjirokaster, Dropull, Memaliaj, Tepelene, Libohove, Permet, Këlcyrë, Shijak</p>

**BASHKËPUNIMI
KOMBËTAR-RAJONAL-QEVERISJE VENDORE**

Problemi	Modalitete e zgjidhjes	Ku ka ndodhur sukseshëm?
Akresi i qytetarëve tek shërbimi i barnave të rimbursueshme	<ul style="list-style-type: none"> Vendosja e nje triazhimi (mjek familje, drejtori dhe farmaci) dhe gjenerimi në kohë reale i recetës së barnave. Në kohë ngarkese shërbimi i çuarjes në shtëpi i barnave bëhet nga policia bashkiake. Skemë bashkëpunimi me qendrën shëndetsore dhe ambulancat për shpërndarjen e ilaceve në shtëpitë e të sëmurëve. 	Vlorë dhe Drejtoria e kujdesit të detyrueshem shëndetësor Pustec, Dropull, Tepelenë, Libohovë, Gjirokastrë, Memaliaj, Ura Vajgurore
Ofrimi i ndihmës për shpërndarjen e bazës ushqimore për shtesat në nevojë apo moshat e treta	<ul style="list-style-type: none"> Shpërndarje e pakove ushqimore nga rezervat e shtetit në bashkëpunim, (Ministria e Mbrojtjes, Prefektuar dhe Bashkia). Stafi i prefekturës ka mbledhur ndihmë në të holla të cilat do i menaxhojë bashkia për shtresat në nevojë. Ngrihet Komiteti Vendor për ofrimin e asistencës në Qark Prefekti nxjerr udhëzimin për organizimin e Mbedhjeve online Nr.46, date 25.03.2020 (sipas udhëzimit për procedura të këshilluar nga BtF) 	Kurbin, Lezhë Lezhë Kukës Kukës
Zbatimi i rregullave të vetëkarantinimit për limitimin e shpërndarjes	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim i strukturave të DVP, ushtrisë, FNSH, policisë Bashkiake dhe inspektoriateve për zbatimin me korrektësi të rregullave tëvetëkarantinimit. Filiali Postës Shqiptare në bashkëpunim me bashkitë ka vazhduar shpërndarjen e pensioneve në çdo shtëpi. 	Shkoder, Pukë, Malësi e Madhe, Fushë Arrez, Vau i Dejes, Berat Shkoder, Puke, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Vau i Dejes, DIVJAKË

TRASPARENÇË, NDËRGJEGJËSIM DHE LLOGARIDHËNIE

Problemi	Modalitete e zgjidhjes	Ku ka ndodhur sukseshëm?
Thyerja e rregullit të "distancës sociale" në njësitë e shërbimit	<ul style="list-style-type: none">Afishim i numrit të klientëve që mund të rrinë brenda në njësitë e shërbimit njëjtën kohë (ndihmë policia bashkiake).Përdorim i medias lokale për informim dhe trajtim ankesash online (e-mail)	Korcë Kukës, Berat
Ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm i qytetarëve për situatën COVID 19	<ul style="list-style-type: none">Video sensibilizuese nga Kryetari dhe Këshilltarët	Shijak, Shkodër
Informim i publikut mbi punën dhe masat e mara në nivel bashkie	<ul style="list-style-type: none">Raporte të punës së zhvilluar nga të gjitha strukturat e bashkisë ofrohen në faqen e facebook-ut	Puke, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Vau i Dejes, Shkodër

PËRMBUSHJA E FUNKSIONEVE VENDORE

Problemi	Modalitete e zgjidhjes	Ku ka ndodhur sukseshëm?
<p>Shërbimet Sociale Fonde te pamjaftueshme për të përballuar emergjencën COVID me burimet e alokuara financiare në buxhetet vjetor (veçanërisht në mbështetje të shtresave në nevojë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> Fondet e miratuara për furnizimin me ushqime të kopshteve dhe cerdheve kalojnë si fond për ndihmën e familjeve në nevojë (1500). Mbështetje e familjeve në nevojë apo ato të goditura nga tërmeti, me ushqime dhe materiale të nevojshme të ofruara nga fondet e bashkive dhe nga donacione private ose fetare (Fondacioni Ndhmë për fëmijët, Kryqi i kuq, Uji I ftohte, Nehemia Gateëay, CFN Albania.) Fondi i caktuar për aktivitetet social-kulturore ka kaluar për familjet në nevojë . 	<p>Vlorë, Shkodër, Malësi e Madhe, Puke dhe Fushë Arrëz</p> <p>Lezhë, Berat, Lushnje, Pogradec Kukës, Lezhë, Shkodër, Pukë, Malësi e Madhe, Fushë Arrës, Pogradec, Kukës, Mat, Dibër, Bulqizë, Klos, Fier, Krujë, Pogradec, Kurbin,</p> <p>Kukës</p>
<p>Zhvillimi Ekonomi Kushtet për lehtësimin e prodhimit vendas Lehtësimi i transportit për fermerët (biznesin e vogël)</p>	<ul style="list-style-type: none"> Tregje të vogla “fshatare” të lëvizshme nëpër lagje të qytetit (tregtarët të pajisuar me mjete mbrojtëse) Mbështetje e sektorit të bujqësisë (nevoja për të nxitur produktin vendas në kushtet e vështirësisë me importet si një zgjidhje afatgjatë). Asistim fermerësh me aplikim për leje udhëtimi të vlefshme për transportin e ushqimit të blegtorisë . Specialistët e Drejtorisë Bujqësisë ndihmojnë fermerët në zbatimin e procedurave. Vazhdon identifikimi dhe raportimi i dëmeve të shkatuara nga tërmeti i nëntorit nga skudrat e inxhinierëve të bashkisë. 	<p>Fier</p> <p>Maliq, Mat</p> <p>Roskovec, Memaliaj, Vlora, Kukësi</p> <p>Lezhë</p>
<p>Siguria Publike Përmbushja e detyrave funksionale edhe në kohë emergjence</p>		

Nevojë për pajisje speciale mbrojtëse për personelin mjekësor, infermier dhe bashkisë.

- Ardian Skendaj, këshilltar i këshillit bashkiak, Vlorë, njëherazi administrator dhe pronar i “K.A Trading” ka dhuruar një sasi të konsiderueshme pajisjesh mbrojtëse për personelin mjekësor dhe infermier dhe punonjësit e shërbimeve në Bashki

Vlorë

Nevoja për mjete shtesë
Desinfektuese
Përdorim i transportit publik për persona kyç

- Fermerët vënë në dispozicion mjetet e tyre për dizefektim (falas)
- Autobuzët e linjave urbane në përdorim vetëm për staf mjekësor duke u dizefektuar çdo ditë. Policia bashkiake ndihmon në përdorimin e shërbimit vetëm nga personat e lejuar.

Maliq

Tiranë, Kamëz

Shërbime publike

Dizefektim i ambienteve publike

Kompania e pastrimit të qytetit në kontratë me bashkinë ka zbrazen e përditshme të konteniereve të mbetjeve, dezinfektimin me klor rreth tyre dhe larjen e fshirjen e rrugëve. Në përgjigje të nevojës për disinfektimin e rrugëve me preparate të posacme ka ofruar falas këtë shërbim.

Vlorë

- Dizefektimi i ambienteve publike, shtrirë dhe në zonat rurale. Në zonat urbane ndërveprim me administratorët për dizefektim brenda pallateve.

Tiranë, Fier, Gjirokastrë

Aktivitete Zbavitëse

- Konkurs kreativiteti i fëmijëve në bashkëpunim me median lokale dhe autoritete të kulturës.

Lezhë

